

TEACHING STRATEGY FOR WRITING DESCRIPTIVE ESSAY AND ITS SELF-ASSESSMENT BY STUDENTS

Merita Banjica

Faculty of Languages, Cultures and Communication SEEU, Tetovo, North Macedonia
meritabanjica@yahoo.com

Abstract: This work as an object of study has the reflection of a teaching strategy for writing descriptive essay turned into didactic scientific theory and its self-assessment by students. Creation is the highest level of cognitive field, where all knowledge is synthesized to generate a final product — individual creation — descriptive essays. The process of writing creation requires the activation of the processes of critical thinking, problem solving, and creative thinking reflected in the unique framework or whole creation. The strategy of writing the descriptive essay is based on the correlation of some theoretical scientific aspects such as didactic, psychological, constructivist, linguistic and communicative.

In this research, the method of scientific theory was used to clarify the key concepts, the empirical applied action method of teaching practice for writing descriptive essays. The research method of survey with pre-prepared questionnaires with open-ended questions and quantitative-qualitative analytical methods for processing reflected in the questionnaires.

The purpose of this paper is to reflect the advantages the teaching strategy for creating descriptive essay by students by acquiring knowledge of the writing process, applying procedures and developing creative mastery skills. This goal is based on several objectives:

- The first part will provide theoretical explanations of key concepts.
- In the second part will be offered a teaching strategy for writing a descriptive essay implemented with students of IX grades in the Primary School "Ismail Qemali" Gostivar.
- The third part will reflect the findings reflected in the questionnaires from the students' self-assessment of the use of the writing strategy, analysis and discussion of the data and will formulate the conclusions.

Keywords: descriptive essay, recollection, character portrayal, teaching strategy.

SRATEGJIA E MËSIMDHËNIES PËR TË SHKRUARIT E ESEJËS PËRSHKRUESE DHE VETËVLERËSIMINE STRATEGJISË NGA NXËNËSIT

Merita Banjica

Faculty of Languages, Cultures and Communication SEEU, Tetovo, North Macedonia
meritabanjica@yahoo.com

Abstrakt: Ky punim si objekt studimi e ka pasqyrimin strategjisë mësimore për të shkruarit e esejeve përshkruese, të cilën e shndërron në teori shkencore didaktike dhe pasqyrimin e gjetjeve për vetëvlerësimine strategjisë nga nxënësit. Strategjia e të shkruarit të esejeve përshkruese mbështetet në korrelacionin e disa aspekteve teorike shkencore si didaktike, psikologjike, konstruktiviste, gjuhësore dhe komunikuese.

Në këtë hulumtim u përdoren metoda e teorisë shkencore për sqarimin e koncepteve kyçe, metoda empirike aplikative aksionale e praktikës mësimore për të shkruarit e esejeve përshkruese, metoda hulumtuese e anketimit me pyetësorë me pyetje të hapura dhe metoda analitike sasiore dhe cilësore për përpunimin e të dhënave të pyetësorëve. Qëllimi i këtij punimi është reflektimi i përparësive të strategjisë së mësimdhënies për procesin e të krijuarit të esejeve përshkruese nga vetëvlerësimi i procesit të shkruarit nga vet nxënësit për përvetësimin e njohurive për procesin e të shkruarit, zbatimin e procedurave dhe zhvillimin e shkathtësive të mjeshtresisë të krijimtarisë. Ky qëllim mbështetet në disa dy objektiva:

- Në pjesën e parë do të ofrohen sqarime teorike për konceptet kyçe.
- Në pjesën e dytë do të ofrohet një strategji e mësimdhënies për të shkruarit të një eseje përshkruese e zbatuar me nxënës të klasave të IX në Shkollën Filllore "Ismail Qemali" Gostivar.
- Në pjesën e tretë pasqyrohen gjetjet e reflektura në pyetësorë nga vetëvlerësimi i nxënësve për strategjinë mësimdhënies për procesin e të shkruarit, analiza dhe diskutimi i gjetjeve dhe formulimi i përfundimeve.

Fjalët kyçe: ese përshkruese, rikujtesa, portretizimi i personazhit, strategji e mësimdhënies.

1. HYRJE

Eseja është krijimi më i kërkuar në veprimtarinë krijuese të shekullit XXI si në nivel lokal, rajonal dhe global, prandaj çdo nxënës prej në shkollë fillore duhet të mësohet të shkruaj ese. Krijim do të thohet të gjenorosh diçka të re duke përdorur njohuritë e qëndrueshme në tru, që aktivizohen me ngacmime të jashtme psikologjike. Të krijuarit ose procesi i të shkruarit është niveli më lartë i fushës kognitive, ku bëhet sinteza e të gjithë njohurive me aktivizimin e proceseve së të menduarit kritik, të menduarit problemor dhe të menduarit krijues për t'u pasqyruar në një kornizë tematike si tërësi unike, krijim ese përshkruese.

Vet titulli i temës së parashtruar është ngacmimi i parë psikologjik, që çdo nxënës e shtyn të mendojë si ta formulojë temën, që në fakt është edhe problemi i parashtruar. Formulimi i temës kërkon aktivizimin e të menduarit krijues dhe të menduarit kritik për të zgjidhur problemin e arritjes së krijimit të esejes përshkruese me të rikujtuarit e përceptimeve të para të bëra të objektit për ta bërë portretizimin e personit, të rikujtuarit e hapësirës ku kanë vepruar së bashku, të rikujtuarit e aktiviteteve të zhvilluara me të dhe të rikujtuarit e përjetimeve emocionale të shfaqura në momentet e bashkëveprimit me të. Në vijim keni edhe gjetjet në pyetësorët e nxënësve, përfundimet dhe rekomandimet.

1.2. SQARIMI I KONCEPTIT ESE PËRSHKRUESE

Eseja është krijim me shkrim kritik individual i një personi, që reflekton pikëpamjet individuale për ndonjë çështje shkencore (mendimet për të drejtën ose të padrejtën, të mirën apo të keqen, funksionalen apo jofunksionalen, të bukurën dhe të shëmtuarën), kulturore të jetës shoqërore, por të cilën krijuesi e shpreh me një ndjenjë të thellë subjektive si përjetim individual. (Banjica, 2020; Musai, 2007).

Eseja përshkruese është një lloj krijimi individual, ku bëhet përshkrimi në detaje i një individi, një objekti, sendi, hapësire, të një ngjarjeje të përjetuar apo një përjetimi emocional. Ajo u ofron lexuesve një kuptim më të fuqishëm të një teme të veçantë sepse e zbkuron atë me detaje dhe përdor mjaft figura stilistike, por jo të tepruara. Të ushtruarit e të shkruarit të esejeve përshkruese u ndihmon nxënësve të zotërojnë edhe artin e shkrimit përshkrues. Esejat e mira përshkruese mund të marrin formën e artikujve në gazeta, raporteve të librave, punimeve kërkimore, tregimeve të një ngjarjeje të vetme, udhëtarëve dhe kujtimeve të një përvoje personale. (Caulfield, 2020; Joyce Carol & Oates, 2020; Musai, 2007).

Tema e caktuar e esejes kërkon organizim të shprehjes së mendimeve për t'u komunikuar sa më mirë nga lexuesi, që të kuptohet tema dhe ideja e saj, të shkruhet në mënyrë pragmatike. Esejat nga pikëpamja e krijuesit janë:

- *pikëpamje shkencore* (sipas teorisë shkencore)
- *pikëpamje joshkencore* (nga përditshmëria).

Krijuesi eseist niset nga një dukuri e caktuar, që në ese e trajton duke e sqaruar, përshkruar, argumentuar dhe vlerësuar. Esejat sipas temës që e trajtohet klasifikohen në: *treguese, argumentuese, përshkruese, krahasimtare, vlerësuese*. (Banjica, 2020; Musai, 2007).

1.2.1. Sqarim për për strukturën dhe përmbajtjen e esejes përshkruese

Në paragrafin e parë eeseisti e pasqyron idenë me sqarimin e fjalëve kyçe, që e bëjnë këtë individ shumë të vlefshëm për ju. Përshkrimin e vazhdoni në detaje duke e konkretizuar identitetin e tij, kohën, vendin dhe shkakun e afërsisë, që e keni pasur me të. Në vijim vetëm përmenden cilësitë dominante të tij, që juve ju kanë lënë përshtypje emocionale pozitive ose negative, që në detaje përshkruhen në paragrafin e dytë, kurse përmendet edhe nodnjë aktivitet të zhvilluar me të, që përshkruhet në paragrafin e tretë dhe të katërt. Paragrafët shkruhen me 4-5 rreshta, horizontalisht në të dy anët kanë largësi të njëjtë, kurse vertikalisht në një drejtim.

Te paragrafi i dytë fillon përshkrimi për atë koncept, që është përmendur e para në paragrafin e parë, në rastin tonë portretizimi në detaje i personit më të afërm, i pamjes së jashtme (fizike) të këtij personi, kurse pastaj bëhet edhe përshkrim i sjelljes së tij ndaj të tjerëve ose vet autorit, që e reflekton edhe kulturën e personit të afërm duke ndikuar edhe gjendjen emocionale të tij kur e ka afër, i shfaqet gëzimi ose frika.

Te paragrafi i tretë jepet një përshkrim i përjetimeve të përbashkëta, të krijuesit me personin e afërm, përshkruhen ndjenjat e shfaqura gjatë kryerjes së aktiviteteve të ndryshme me të si kënaqësia (disponimi dhe siguria) ose pakënaqësia (pesimizëmi dhe josisuria ose frikë. Të gjitha këto emocione përshkruhen në detaje me figura stilistike si epitete, metafora të ndryshme, pyetje retorike që esejen ta bëjnë më tërheqëse.

Te paragrafi i katërt mund të jepen në vijim mund të përshkruhen të veprimet e ndryshme të përjetuara me këtë person të afërm dhe bëhet edhe përshkrimi i vendit, objektit apo hapësirës dhe aktiviteteve, që janë bërë gjatë këtyre përjetimeve me përdorimin e epiteteve të ndryshme, por jo të tepruara. Në vijim reflektohet edhe dëshira për përsëritjen e këtyre përjetimeve në afërsi të personit më të dëshiruar. Mendimet e shprehura në paragrafë duhet të kenë lidhshmëri me njëra tjetrën, ashtu që në paragrafin e fundit bëhet përmbledhje e mendimeve.

Te paragrafi përmblyës zakonisht përdoret ideja e shpehur në paragrafin e parë dhe përmbledhjen edhe detaje nga paragrafet e brendisë (paragrafet 2-3). Nëse mendoni se duhet të shkruani akoma për këtë temë, para paragrafit përfundimtar mund të shtoni edhe një paragraf, por në paragrafin e fundit i shtoni edhe detajet nga ai paragraf, ashtu

që paragrafi përmbyllës t'i përfshijë të gjitha detajet nga të gjithë paragrafët. Ky paragraf në fund duhet të mbarojë me fjalën me të cilën e keni filluar esejën në fillim të paragrafit të parë. Përdorimi i figurave letrare në esetë përshkruese i japin asaj një formë gjallërie, që shpesh herë ngel gjatë në kujtesën e lexuesit.

1.2.2. Portretizimi e personazhit

Portretizimi i personazhit bëhet sipas përshkrimit të jashtëm (fizik) dhe përshkrimit të brendshëm fizik. Autori te përshkrimi fizik përqendrohet në rikujtesën e pjesëve të pamjes së jashtme të personazhit: trupi, flokët, fytyra, sytë, goja, veshja, etj. Përshkrimi i brendshëm mund të jetë psikik (si mendon?) dhe emocional (çfarë ndjen? , si vepron? dhe si sillet me të tjerët?). Të gjithë këto cilësi të personazhit përshkruhen në bazë të përeceptimeve të para të bëra nga autori, që janë mbajtur mend në trurin e tij dhe përsëri i rikujton duke e përfytyruar personin, duke e rikujtuar përsëri përeceptimin e figurës së tij, por pak më të zbehtë se sa kur e ka perceptuar në fillim në detaje. Përshkrimi bëhet me figura stilistike, që bëjnë më të gjallë dhe më tërheqëse për lexuesin, por përdorimi i tyre nuk duhet të jetë i tepruar se ideja kryesore fillon ta humb vlerën e saj.

1.3. Sqarimi i konceptit rikujtim, vëmendje dhe parafytyrim

Rikujtimi ose riprodhimi i diçkajit varet nga përfytyrimi i çastit të njohjes dhe përjetimit të parë me njohurinë.

Rikujtimi është proces psikik i riprodhimit të asaj, që është mësuar ose përjetuar më parë duke e përfytyruar çastin e perceptimit dhe përjetimit të parë të personit, objektit, sendit apo hapësirës me vëmendje për ta mbajtur mend në trurin e tij.(Banjica,2020; Osmanaj, 2017; Spahiu, 1999).

Gjatë kësaj njësie mësimore duhet të nxitet rikujtesa e nxënësit për të përfytyruar personin më të afërm, për t'i rikujtuar aktivitetet dhe përjetimet e kaluara me të në objekt ose hapësirë. Mirëpo për ta nxitur procesin e rikujtesës (riprodhimit) te çdo nxënës duhet të aktivizohet procesi i kujtesës (retencioni) për perceptimin e parë të personit të bërë më parë, për ta rikujtuar figurën, aktivitetet dhe përjetimet e bëra me të. Për ta kuptuar më mirë procesin e rikujtesës në vijim në mbështetje të teorisë shkencore psikologjike ofrohen sqarimet e koncepteve kujtesa, rinjohja, rikujtesa, përfytyrimi, vëmendja, përjetimi dhe emocioni.

Kujtesa, të mësuarit dhe harresa janë tri procese të ngushtëlidhura, që vihen në lidhje ndërmjet tyre dhe së bashku përbëjnë një kontinuitet procesesh të njëpasnjëshme dhe të pandara ndërmjet tyre. Të mësuarit shkakton ndryshime në strukturën nervore dhe në lidhjet ndërmejt tyre. Kujtesa është proces intelektual, por edhe aftësi e posaçme e individit për ruajtje, rinjohje dhe riprodhim të njohurive dhe ndryshimeve të tyre, kurse harresa është zbehje, humbje, zhdukje e këtyre ndryshimeve nervore dhe dobësim e humbje e lidhjeve të këtyre ndryshimeve. (Banjica,2020; Burtun, 2019; Spahiu, 1999). Kujtesa dhe funksioni i saj vërehen në tri procese të saja:

- *Retecioni (të mbajturit mend)* fillon me mbajtjen mend të lëndës, që njeriu e mëson (përmbajtjeve), që e përcjell gjatë kontaktit të tij të parë me objektet, me dukuritë dhe me proceset e ndryshme të realitetit.
- *Rikonjicioni (rinjohja)* ndodh kur individ i lexon, e pranon, e percepton ndonjë njohuri të njohur nga më parë.
- *Riprodhimi asaj, që është mësuar ose përjetuar më parë dhe tani përfytyrohet.* Riprodhimi është ringallje gjurmësh nervore të përmbajtjeve fjalësore, perceptimesh dhe lëvizjesh të mësuara nga individ, që i parafytyrohen.

Vëmendja është aktiviteti mendor në një numër të kufizuar ngacmimesh, që individ i selekcionon në momentin e duhur nga ngacmimet e shumta, që i vijnë nga jashtë. Vëmendja është drejtim i vetëdijes dhe i aktivitetit tonë në një objekt apo detyrë të caktuar. Ajo është karakteristikë e të gjithë proceseve psikike, veçanërisht intelektuale. P.sh. Ne sa herë ndiejmë nevojë për një cilësi të një objekti atë e perceptojmë, e përfytyrojmë, mendojmë për të, njihemi me të, e mbajmë mend dhe e vlerësojmë përjetimin tonë. (Osmanaj, 2017; Spahiu, 1999).

Faktorët që nxisin aktivitetin e vëmendjes janë:

- Faktorë të jashtëm (madhësia e ngacmimit, forca, lëvizja, ndërpreja e ngacmimit p.sh. *të folurit e zëshëm*),
- Faktorë të brendshëm ose subjektivë (motivet, interesimet, shpresat, aftësitë, emocionet, qëndrimet etj.). Interesimi është faktori më i rëndësishëm, që përcakton cilësinë e të perceptuarit, të mësuarit, të menduarit dhe ndihmon vëmendja të zgjas shumë.

Përfytyrim quhet aftësia e individit për të përtërirë në vetëdije objekte apo dukuri të perceptuara më parë, është një lloj riprodhimi i perceptimeve në bazë të kujtesës. Përfytyrimi lind pa ndikimin e ngacmuesit të jashtëm në bazat përkatëse organike dhe është i lidhur me kujtesën e individit, ku aktivizohen aftësi mendore për të rikujtuar në vetëdije të gjithë aftësitë mendore të ndodhur më parë si të perceptuarit, të ndijuarit, të kujtuarit, të menduarit për të arritur qëllimin e caktuar, kurse gjatë perceptimit nëpër shqisa vepron një lloj ngacmuesi. Përfytyrimi është më pak e gjallë, më pak e plotë dhe jo aq e qartë se sa perceptimi. (Osmanaj, 2017; Spahiu, 1999).

Përjetimi është procesi psikik, që realizohet me perceptimin i formës me cilësitë veta të objektit dhe ndijimin. Objektet e ndryshme vërehen si tërësi unike, ku cilësitë e veçanta (ndijimet) shkrihen në një tërësi unike (perceptim) të objektit të caktuar, ashtu që të dy proceset në tru përjetojnë si dukuri psikike . Ndijimi si aftësi fizike dhe psikike e njeriut të shëndoshë shpreh gatishmërinë e njeriut të perceptojë objekte në botën rreth tij përmes ngacmimeve të ndryshme të vërejmë atë, që na e tërheq vëmendjen tonë. (Osmanaj, 2017; Spahiu, 1999).

Emocionet janë procese të veçanta psikike (shqetësime shpirtërore), që lidhen me mënyrën e reagimit të individit ndaj objektit ose dukurive të ndryshme, që paraqesin lloj përjetimi subjektiv të njeriut (gëzim, shpresë, dashuri, frikë, brengosje, hidhërim, zemërim etj.). Njeriu vlerëson veten dhe realitetin objektiv në bazë të emocioneve, që atij i mundësojnë të marrë qëndrim pozitiv ose negativ ndaj asaj, që është perceptuar më parë, mësuar ose është njohur më parë. Emocionet sipas ngjarjeve të shkaktuara nga vetja ose nga të tjerë klasifikohen sipas polaritetit: 1. *Emocione pozitive –optimizmi* (ndjenja e kënaqësisë dhe sigurisë): i lumtur, i gëzuar, i kënaqur, në harmoni me vetveten dhe i suksesshëm në jetë). 2. *Emocionet negative–pesimizmi* (ndjenja e pakënaqësisë dhe jositurisë): individ i përjeton frikë, ankth, zhgënjim, dëshpërim, zemërimin, trishtimi, neveri, frustrimetj. Emocionet negative që krijojnë probleme në shëndetin mendor të individit dhe në sjelljen e tyre janë frika, ankthi, fobitë dhe zemërimi. (Banjica,2020; Krasniqi, 2016; Spahiu, 1999; shih: <https://ikm.mk/ojs/index.php/KIJ/article/view/4660>).

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë hulumtim u përdorën metoda teorike shkencore për sqarimin e koncepteve kyçe, metoda empirike aplikative aksionale (vepruese), që demonstroi strategji të mësimdhënies nga përvoja ime, ku bëhet shndërrimi i përvojës së mësimdhënies e realizuar me platformën Microsoft Teams në teori shkencore didaktike dhe metoda empirike e anketimit me pyetësorë me pyetje të hapura.

Gjatë këtij hulumtimi empirik aplikativ aksional u përdor metoda e vëzhgimit të nxënësve për të verejtur reagimet e tyre gjatë procesit të shkruarit të esejës, por për validitet të kësaj strategjie u zhvillua edhe një anketim me anë të pyetësoreve për vetëvlerësimin e strategjisë së shkruarit të esejës përshkruese të formuluar me dhjetë pyetje. Mostra ishte e qëllimshme, por e rastësishme, ku u përfshin nga 7 nxënës të klases IX në pesë klasa me sukses të niveleve të ndryshme., gjithsej 35 nxënës të shkollës fillore “Ismail Qemali” në Gostivar. Gjetjet u analizuan dhe u diskutuan sipas analizës sasiore dhe cilësore. Përfundimet dhe rekomandimet nga ky hulumtim pasqyrohen në fund të punimit.

Variabël e pavarur: Strategjia e mësimdhënies së shkruarit ese përshkruese.

Variabël e varur: Zhvillimi i shkathtësive së shkruarit të çdo nxënësi të klases së IX për të krijuar krijime.

Hipoteza: Strategjia e mësimdhënies lehtëson procesin e shkruarit e esejave përshkruese duke ndikuar në përfytyrimin e asaj, që duhet të përshkruhet nga rikujtimi i perceptimeve të para të mbajtura mend gjatë procesit të kujtesës të personit, të hapësirës dhe të aktiviteteve, por edhe të përjetimeve emocionale të përjetuara me të.

3. STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES PËR TË SHKRUARIT E NJË KRIJIMI-ESE PËRSHKRUESE

Metodat dhe teknikat e ndryshme të përdorura gjatë procesit të mësimdhënies së shkruarit janë: sqarim koncepti me organizues grafik, kllasterme “stuhi mendimesh” kur nxënësit nxiten të shprehin mendim për njeriun më të afërm, bashkëbisedim me pyetje divergjente, prezantim, diskutim për vlerësim dhe vetëvlerësim.

Hapësira: Shkolla Fillore “Ismail Qemali”-Gostivar

E premte, 23.04.2021

Mësim nga distanca me nxënës të klases të IX: Microsoft Teams.

Tema: Të shprehurit dhe krijimtaria-Ese përshkruese

Njësia mësimore: Ushtrim së të shprehurit me shkrim.

Tema: “Rikujtimi i një personi të afërm”

Kohëhëzgjatja: 13:00-13:30

Format e punës: Frontale, punë e pavarur individuale,

Metodat mësimore: Bashkëbisedim-“stuhi mendimesh”, shpjegim me organizues grafik, punë e pavarur, prezantim, diskutim, vlerësim.

Mjetet mësimore: Power Point, fletorja.

Aktiviteti i nxënësit: Bashkëbisedon, shkruan, prezenton, diskuton dhe vlerëson

Mësim i integruar: Gjuhë shqipe, Biologji, Gjeografi, Informatikë, Arsim qytetar etj.

Hapi i parë: Orientimi i nxënësve për krijimin e esejës përshkruese.

Ju lutem nxënës krijoni një ese përshkruese- krijim origjinal tuajin me vlerë individuale dhe vlerë shoqërore për t’u lexuar edhe nga të tjerë ! Lart shënoni titullin, pastaj esejën, kurse në fund emrin dhe mbiemrin tuaj, emrin e institucionit (shkollës dhe vendin ku ndodhet shkolla juaj), klasën, emrin e arsimtarit dhe në fund datën dhe vendin (ku e shkruani esejën). P.sh:

Rikujtimi i një personi të afërm

Përgatiti: Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: IX/ _____ Arsimitare: Merita Banjica

Hapi i dytë: Sqarim i kocepteve kyçe me organizues grafikë- hartë koncepti

Figura 1.Oragnizues grafik për sqarimin e konceptit person i afërm.





Figura 2.Oragnizues grafik për sqarimin e konceptit përjetim dhe llojet e emocioneve



Hapi i tretë: Sqarim për rrjedhshmërinë e procesit së të shkruarit të esejes përshkruese.

Sqarim për të shkruarit e esejes			
Përmbajtja	Struktura e esejes	Rrjedhshmëria e esejes përshkruese.	Përdorni pyetje divergjente
Hyrja: 1 paragraf	Eseja klasike shkruhet në 3-5 paragrafe	Esejen fillojeni dhe mbaroni me fjalën e njejtë fillim të paragrafit të parë dhe në paragrafin e fundit!	Çfarë vlere ka për ju ai person, pse e rikujtoni vazhdimisht, kush është ku dhe kur e keni takuar?
Brendia: 2-3 paragrafë	Çdo paragraf të ketë 4-5 rreshta	Gjatë të shruarit përdorni foljet në vetën e I dhe III njëjës dhe shumës për të përshkruar personin e afërm ose hapësirën kua keni lëvizur së bashku!	Si dukej ajo.ai? Bëni portretizimin duke u përqendruar në disa detaje, që jua kanë tërhequr vëmendjen!
Përfundimi: 1 paragraf		Krijoni fjalitë sipas rendit të zakoshëm (kryefjalë, përcaktorë, kallëzues, kundirnor)	Çfarë sjellje reflektonte ai/ajo ndaj jush? Çfarë raporte keni pasur me të (miqësore ose të mira apo armiqtësore)?
		Përdorni shenjat e pikësimit për të krijuar ritmin, që të dallohet intonacioni i zërit gjatë të lexuarit!	Çfarë aktiviteti keni bërë bashkë me të? A ishit të suksesshëm në kryerjen e aktiviteteve?
			Si ndjeheshit ju në afërsinë e personit të afërm? A dëshironi ta mbani mend çdoherë në mendje atë person se ju bënë të lumtur dhe të suksesshëm ose dëshironi ta fshihni nga mendja juaj se ju zemëronte dhe ju bënë të hidhëroheni, dëshironi ta harroni dhe kurrë të mos e kujtoni?

Hapi i katërt: Në hapin e pestë çdo nxënës e shkruan esejen, e kontrollon, e korrigjon dhe riformulon esejen. Esejen në fillim shkruajeni në një fletë !

- Rishikojeni esejen!
- Lexojeni para vet esejen !
- Korrigjojeni esejen!
- Jepjani ta lexojë dikush tjetër me zë!
- Dorëzoheni esejen!
- Prezantoheni esejen përshkruese para shokëve!

Hapi i pestë: Prezantim të esejeve të nxënësve: Në vijim ofrohen dy produkte finale ose krijime të esejes përshkruese të krijuar nga nxënësit e klasës së IX.

Rikujtimi i një personi të afërm

Njerëzit bëhen me vlerë për ne nëse asnjëherë nuk largohen nga mendja jonë dhe vazhdimisht qëndrojnë në mendimet tona. Një person i tillë për mua është Eliza, të cilën e takova vitin e kaluar në Zvicër kur isha për pushime. Ajo ishte një vajzë me flokë të gjata, sy të kaftë dhe vazhdimisht mbante syza, ashtu që ajo dallohej nga larg. Eliza ishte shumë e shoqërueshme dhe vazhdimisht i mbështeste mendimet e mia, kur ato unë i shpehja para saj. Momentet e bukura dhe interesante, që i kalova pranë saj kurrë nuk do t'i harroj.

Eliza çdoherë ofronte disponim, ngrohësi dhe qetësi shpirtërore me mirëkuptimin e saj, që herë shfaqej me skuqe në fytyrën e saj. Ne takoheshim gati çdo ditë derisa isha në Zvicër, ashtu që edhe koha më kalonte shumë shpejt kur ndodhesha pranë saj. Këtë vit nuk pata mundësi të shkoj në Zvicër, për shkak të situatës së pandemisë të krijuar nga virusi Korona, Covid-19. Mirëpo, ne edhe pse nuk jemi takuar gjatë kohë, komunikimet i vazhdojmë përmes rrjeteve sociale, që na mundëson interneti.

Zvicra ishte një shtet shumë i bukur dhe shumë i pastër. Eliza dhe unë të shoqëruar nga familjet tona arritëm të vizitonim disa qytete të bukura si Zurich, Lucern dhe Rapperswil. Ne pamë disa liqej, pishina, qendrat tregtare, muzeje etj. Unë derisa isha atje më shpesh shkoja te shtëpia e Elizës, por edhe ajo vinte te shtëpia e gjyshërve të mi, pasi që unë qëndroja aty. Ne luanim bashkë në oborrin e gjyshërve të mi dhe ndonjëherë dilnim edhe në lagje. Gjatë tërë kohës kur isha pranë saj ndjeja siguri, kënaqësi, disponim dhe sukses në çdo punë.

Eliza ishte një person, që rrezatonte energji pozitive, ashtu që pranë saj unë çdoherë ndihesha e lumtur, e gëzuar dhe qeshur. Unë jam shumë e fat që arrita ta njoh dhe të krtoj raporte miqësie me të. Ajo për mua ishte një person shumë me vlerë, prandaj edhe nuk dëshiroj ta harroj kurrë. Unë kam dëshirë edhe në të ardhmen ta mbajë miqësinë me të, prandaj me shpirt pres pandemia të marrë fund, të shkoj në Zvicër e të takohem përsëri me Elizën. Personi i afërm është vlerë e çmuar e çdo individi në shoqëri, që ofron kënaqësi, siguri, besnikëri dhe lumturi për të gjithë njerëzit.

Përgatiti: Jelida Shabani
23.04.2021, Gostivar

Klasa: IX/3

Arsimtare: Merita Banjica E premte,
Sh.F. "Ismail Qemali" Gostivar

Rikujtimi i një personi të afërm

Çdo njeri ka ndonjë person të afërm, që i ndihmon për t'i zgjidhur problemet nga çdo aspekt jetësor dhe ia përmbush zbrastirat shpirtërore duke ia ofruar praninë dhe bashkëbisedimin miqësor, prandaj ai person bëhet i veçantë edhe nuk harrohet kurrë, por e rikujton me mall çdo moment të kaluar me të, edhe nëse jeta të ndan nga ai përgjithmon. Ndoshta për të tjerët do të jetë e pabesueshme se personi më i afërm i imi ishte stërgjyshja ime. Ajo për mua bëhej gjithçka që doja, bëhej lodra ime fëmijërore dhe bëhej shoqja ime për biseda fëmijërore. Ajo më donte si vajzën e saj. Stërgjyshen time të ndjerë shpesh herë e rikujtoj me shumë mall. Çdo aktivitet të bërë me të vazhdimisht i rikujtoj të duke i rikujtuar edhe përjetimet e kënaqësisë, lumturisë dhe sigurisë, që kurrë nuk do t'i harroj. Ajo ishte plaka më e mirë në botë, buzëqeshja e së cilës kurrë nuk zhdukej nga fytyra e saj. Ishte libër i gjallë që më tregonte përrallat e jetës reale të së kaluarës së saj. Gjatë natës gjithmon rrinte afër meje, e ndonjëherë mendoja se nuk flinte asnjëherë. Ende më kujtohet vendi jonë i fshehtë, ku shkonim zakonisht, pas shtëpisë dhe luanim lojën me flamur, të cilën e dinim vetëm ne të dyja. Lojrat e saj gjithmon ishin zbavitëse, që edhe sot rikujtoj kur i luaj me motrat e mia.

Në vitet e fundit të jetës së saj, ajo u verbua, por kurrë nuk e humbi dëshirën për të ditur se si dukem unë e sa jam rritur, çdo ditë më përqafoje dhe më përkëdhelte me duart e saja të këputura. Si mund të mos e kujtoj një person të tillë, në krahët e së cilës jam rritur. Jeta është e tillë, i merr me vete ato që i do ajo. Stërgjyshja ime gjithmon do të ngel në kujtesën time si personi më i veçantë i jetës sime, për të cilën çdo ditë edhe më shumë më merr malli. Pikëllimi më i madh është kur e humb personin më të afërm, që të ofron dashuri dhe mirëkuptim.

Përgatiti: Arisa Neziri
E premte, 23.04.2021, Gostivar

Klasa: IX/3

Arsimtare: Merita Banjica
Sh.F. "Ismail Qemali" Gostivar

Hapi i gjashtë: Disikutim për vlerësim të esejeve.

- Çfarë ju pëlqeu më tepër nga prezantimet që i dëgjuat.
- Cila ese kishte përmbajtje më të mire?
- A ju ndihmojnë leximi i esejeve të shokëve tuaj?
- A dëshironi të shkruani eseja të tjera?
- A dëshironi ta botojmë një libër me eseja tuaja?

Hapi i shtatë: Pjesa emiprike-Vetëvlerësim i strategjisë së të shkruarit : Në vijim e pasqyrojmë pyetësorin e përgatitur për 35 nxënës të klasës IX, me të cilin i zbuluam avantazhet e procesit të shkruarit.

5. GJETJET NË PYETËSORËT E NXËNËSVE

Ju lutem nxënës,

Ky pyetësor përmban disa pyetje, që ju duhet t'iu përgjigjeni me objektivitet për të zbuluar vlerën e strategjisë së mësimdhënies për procesin të shkruarit e krijimeve. Mua personalisht më intereson, se cila metodë dhe teknikë e mësimdhënies ju ndihmon juve më tepër për të shkruar një krijim me shkrim të mirë, që të jetë i kuptueshëm për të tjerët (pragmatik). Pyetësi është anonim, prandaj ju lutem të jeni sa më objektiv me përgjigjet tuaja!

1. **Në fillim të orës nëse mësimdhënësi pasi e shënon titullin e temës në dërrasë të zezë jua tregon kriteret e vlerësimit ju atëherë përpigjeni t'i arrini ato.**
 - a) Po, unë përpigem të arrijë t'i plotësojë ato. - 35 (100%)
 - b) Jo, aspak nuk përpigem t'i arrijë ato, por vetëm shkruaj - 0 (0%)
 - c) Aspak nuk filloj të shkruaj. - 0 (0%)
2. **Në fillim të orës nëse mësimdhënësi ju thotë se ju me të shkruarit e një krijimi e filloni edhe përvojën tuaj si shkrimtarë, punimi i së cilit mund të ketë edhe vlerë shoqërore (të lexohet para tjerëve dhe të ndikojë pozitivisht tek atë) si do të veproni ju?**
 - a) Do t'i qasem të shkruarit me vullnet për t'i impresionuar lexuesit ose dëgjuesit - 26 (74%)
 - b) Do t'i qasem të shkruarit të krijimit më me kujdes për të mos pasur gabime drejtëshkrimore se nëse kam gabime mund të kem kritika nga të tjerët. - 9 (26%)
 - c) Aspak nuk filloj të shkruaj deri sa ta dëgjoj punimin e dikujt tjetër. - 0 (0%)
- ç) Aspak nuk i a filloj të shkruarit të punimit. - 0 (0%)
3. **Në fillim të orës nëse mësimdhënësi e shënon titullin e temës në dërrasë të zezë dhe kërkon nga ju të shkruani për atë temë pa mos ju thënë asnjë fjalë tjetër, ju si do të veproni?**
 - a) Nëse nuk kam njohuri të mëparshme për temën nuk do çfarë të shkruaj - 15 (43%)
 - b) Gjatë mund të mendohem për atë temë dhe mund të shkruaj pak. - 20 (57%)
 - c) Aspak nuk filloj të shkruaj - 0 (0%)
4. **Në fillim të orës nëse mësimdhënësi pasi e shënon titullin e temës në dërrasë të zezë kërkon nga ju të tregoni disa ide për fjalët kyçe të temës, të cilat ai i strukturon në një organizues grafik si hartë konceptesh, atëherë të shkruarit tuaj a lehtësohet?**
 - a) Idetë e shprehura nga të tjerë më ndihmojnë shumë për t'i formuluar mendimet dhe fjalitë. - 22 (63%)
 - b) Ato m'i rikujtojnë njohuritë e përvetësuara më parë, që i përdor për ta formuluar esejën. - 13 (37%)
 - c) Aspak nuk më ndihmojnë - 0 (0%).
5. **Nëse mësimdhënësi ju udhëzon për rrjedhshmërinë e punimit për të pasur strukturë kronologjike, formulim të fjalive sipas rendit të zakonshëm, përdorim të përemrave në fjalitë vijuese pas fjalisë së parë, respektim të rregullave drejtëshkrimore dhe shenjave të pikësimit. Si do të veproni ju?**
 - a) Krijimin në fillim e shkruaj në një fletë tjetër, pastaj e rishikoj dhe shkruaj në fletore. - 23 (66%)
 - b) Krijimin e shkruaj dy tri herë në fletore. - 4 (11%)
 - c) Krijimin e shkruaj vetëm një herë në fletore - 8 (23%)
6. **Nëse ju bashkë me mësimdhënësin i parashtroni disa pyetje dhe formuloni kornizë për rrjedhshmërisë së krijimit juve a ju lehtësohet të shkruarit?**
 - a) Pyetjet divergjente ma lehtësojnë të shkruarit, kurse me përgjigjet i formuloj paragrafet - 20 (57%)
 - b) Deri-diku ma lehtësojnë të shkruarit. - 15 (43%)
 - c) Aspak nuk ma lehtësojnë të shkruarit. - 0 (0%)
7. **A ju orienton mësimdhënësi për të shkruarit e krijimit në fillim të çdo ore?**
 - a) Çdoherë na udhëzon si ta bëjmë krijimin. - 32 (91%)
 - b) Ndonjëherë na udhëzon si ta bëjmë krijimin. - 3 (9%)
 - c) Asnjëherë nuk na udhëzon si ta bëjmë krijimin, por vetëm e shkruan titullin në dërrasë - 0 (0%)
8. **A bëhet krijimi juaj më i mirë ?**
 - a) Nëse pasi e shkruani e rishikoni, i korrigjoni gabimet, e lexoni me zë të lartë, përsëri riformuloni krijimin, ia jepni dikujt ta lexojë dhe në fund e dorëzoni te mësimdhënësi ose prezantoni para shokëve. - 34 (97%)
 - b) Asnjëherë nuk e rishikoj, por drejtë e dorëzoj ose prezantoj krijimin. - 1 (3%)
 - c) Mësimdhënësi kurrë nuk ka kërkuar ta rishikojmë krijimin, por vetëm e lexojmë para shokëve - 0 (0%).
9. **A bëhet krijimi juaj më i mirë ?**
 - a) Po, krijimin bëhet më i mirë, pasi që e kontrolloj, ndonjëherë e ndryshoj paragrafët që tema të ketë rrjedhshmëri, pastaj ia jap dikujt ta lexojë dhe e dorëzoj te mësimdhënësi ta kontrollojë. - 34 (97%)
 - b) Jo, unë asnjëherë nuk e riformuloj, pasi që një gjë e tillë nuk kërkohet. - 1 (3%)
10. **Prezantimi i krijimit para të tjerëve në klasë, më jep mundësi për të krijuar vetëbesim për të shkruarit, krijojë përvojë prezantuese dhe më ndihmon të vetëvlerësoj procesin e të shkruarit.**

- a) Gara e prezantimit është metodë vlerësuese dhe vetëvlerësuese i krijimtarisë. - 16 (46%)
- b) Gara e prezantimit më motivion për të shkruar me pragmatizëm - 17 (35%)
- c) Gara e prezantimit më detyron të shkruaj mirë, për të mos u turpëruar para të tjerëve. - 2 (6%)

6. PËRFUNDIM

Përfundimet e formuluar nga të dhënat e reflektuara në pyetësorët e nxënësve:

1. Në pyetjen 1 të gjithë nxënësit janë shprehur për opsionin a) 35 (100%) nxënës janë shprehur se kriteret e vlerësimit në fillim të orës e orientojnë çdo nxënës t'i qaset me vullnet të shkruarit .
2. Në pyetjen 2 në opsionin a) 26 (74%) nxënës janë shprehur se vlerësimi i esejes nga një auditor i nxit nxënësit të shkruajnë pragmatikisht, kurse në opsionin b) 10 (26 %) nxënës janë shprehur se do t'i kushtojnë kujdes rregullave drejtshkrimore për të mos pasur kritike nga të tjerët, që do ta dëgjojnë prezantimin e tyre.
3. Në pyetjen 3 në opsionin a) 15 (43%) nxënës janë shprehur se nëse nuk kanë njohuri për temën nuk dinë të shkruajnë, ndërsa në opsionin b) 20 (57%) nxënës janë shprehur se nëse mësimdhënësi e shkruan vetëm titullin në dërrasë dhe nuk i orientojnë me sqarime atëherë ata më pak shkruajnë
4. Në pyetjen 4 në opsionin a) 22 (63%) nxënës janë shprehur se organizuesit grafikë për sqarimin e fjalëve kyçe në fillim të orës nxënësve u ndihmon shumë, kurse 13(37%) se ua rikujtojnë njohuritë e mëparshme.
5. Në pyetjen 5 në opsionin a) 23 (66%) nxënës janë shprehur se më e mirë bëhet esesa në fillim shkruhet në ndonjë fletore tjetër, nëse rishikohet dhe në fund shkruhet në fletore, ndërsa opsionin c) 8 (23%) nxënës janë shprehur se esejen e shkruajnë vetëm në fletore dhe në opsionin b) 4 (11%) nxënës se të gjithë korrigjimet e esejes i bëjnë në të njëjtën fletore, ku esejen e shkruajnë 2-3 herë.
6. Në pyetjen e 6 në opsionin a) 20 (57%) nxënës janë shprehur se pyetjet u ndihmojnë për t'i formuluar paragrafët më mirë, ndërsa për opsionin b) 15 (43%) janë shprehur se pyetjet janë lehtësuesit më të mirë për të shkruarit se e aktivizojnë të menduarit kritike dhe krijues.
7. Në pyetjen 7 në opsionin a) 32 (91%) nxënës janë shprehur se mësimdhënësi i orientojnë për procesin e të shkruarit, kurse 3 (9%) janë shprehur se ndonjëherë mësimdhënësi i orientojnë.
8. Në pyetjen 8 në opsionin a) 34 (97%) nxënës janë shprehur se esesa bëhet më e mirë nëse rishikohet, korrigjohet, lexohet me zë, riformulohet, i jepet dikujt ta lexojë dhe pastaj të dorëzohet për vlerësim të mësimdhënësi, kurse në opsionin b) 2(3%) nxënës janë shprehur nuk e rishikojnë punimin, por e dorëzojnë të mësimdhënësi .
9. Në pyetjen 9 në opsionin a) 35 (97%) të nxënës janë shprehur se pasi e rishikojnë esejen, i ndërrojnë paragrafët për të pasur rrjedhshmëri esesa gjatë të lexuarit dhe për t'u vlerësuar më note më të lartë.
10. Në pyetjen 10 në opsionin a) 17 (46%) nxënës janë shprehur se gara e prezantimit është metodë vlerësuese dhe vetëvlerësuese e krijimtarisë, kurse në opsionin b) 16 (35%) nxënës janë shprehur se gara e prezantimit i motivion për të shkruar me pragmatizëm (të kuptohet nga të tjerët), ndërsa vetëm 2 (6%) nxënës janë shprehur se gara e prezantimit i detyron të shkruajnë mirë, që të mos u turpërohen para të tjerëve.

7. REKOMANDIME

Në bazë të përvojës sime mësimore me strategji të mësimdhënies për të shkruarit dhe me vetëvlerësimin e procesit së të shkruarit nga nxënësit erdha në konkludim se strategjia e mësimdhënies u ndihmon nxënësve në të shkruarit:

- Kriteret e vlerësimit të kumtuar në fillim të orës e nxisin çdo nxënës me vullnet t'i qaset çdo aktiviteti .
- Organizuesi grafik i nxit çdo nxënës në bashkëbisedim e aktivizon procesin e rikujtesës me riprodhimin e figurave, objekteve, sendeve, hapësirave të mbajtura mend në mendjen e nxënësit.
- Pyetjet divergjente e nxisin të menduarit kritik të çdo nxënësi për ta parafytyruar figurën e të afërmi të tij duke i rikujtuar edhe disa detaje pamjen fizike të tij, të aktivitetëve të bëra me të dhe emocioneve pozitive ose negative të përjetuara me të afërmin e tij, që tani është edhe i paharruar për të.
- Korrigjimi, formulimi i temës dy tri herë në fletë duke i ndërruar edhe vendet e paragrafëve, kurse në fund të shkruhet në fletore nxënësve u sjellë rezultate më të mira në formulimin e produktit final-ese përshkruese.
- Prezantimi para një auditori e nxit çdo nxënës të bëjë krijim të mirë dhe pragmatik.
- Vetëvlerësimi e procesit së të shkruarit e nxit çdo nxënës të shpreh opinionin e tij se cila metodë dhe teknikë i ndihmon më tepër atij për të krijuar një krijim-ese përshkruese.

REFERENCAT

- Banjica, M. (2020). *The approach on teaching writing a creation-essay* (Qasja në mësimdhënien e të shkruarit të një krijimi-ese) botuar në KNOWLEDGE – International Journal, Vol. 42.
- Carol Oates, J., Gaiman, N., & Brown, D. (2020). *MasterClass - How to Write a Descriptive Essay in 7 Steps* Last updated: Nov 9, 2020 , pare më 21.04.21021 në:

- Caulfied, J. (2020). How to write a descriptive essay- Published on July 30, 2020 , Revised on October 15, 2020. parë më 21.04.20121 në: <https://www.scribbr.com/academic-essay/descriptive-essay/>
- Christopher, T. (March 29, 2019). How to teach creative writing parë më 04.02.2020 në: <https://www.wikihow.com/Teach-Creative-Writing>
- Doyle, A. (2020). Critical Thinking Definition, Skills, and Examples parë më 26.09.2020 <https://www.thoughtco.com/critical-thinking-definition-with-examples-2063745>
- Krasniqi, N. (2016). Analiza e pjekurisë emocionale të nxënësve adoleshentë të shkollave të mesme të Republikës së Kosovës si indikatorë për arritjen e suksesit në mësim parë më 30.04.2020 në:
- Musai, B. (2014). Metodologji e mësimdhënies-Arti dhe shkence për të përgatitur nxënës të suksesshëm, Qendra për Arsim Demokratik(CDE), Tiranë.
- Musai, B. (2009). Si të shkruajmë ese?, Qendra për Arsim Demokratik(CDE), Tiranë.
- Musai, B. (2009). Si të shkruajmë objektivat mësimorë për mësimdhënien dhe vlerësimin?, Qendra për Arsim Demokratik(CDE), Tiranë.
- Musai, B. (2006). Strategji të mësimdhënies dhe të nxënësve për klasat mendimtare-Projekti- Zhvillimi i të menduarit kritikë gjatë leximit dhe të shkruarit, Instituti i Shoqërisë së Hapur dhe QAD (CDE), Tiranë.
- Palushaj, R. (2020). Psikologji e përgjithshme, parë më 23.09.2120 në: https://www.academia.edu/24907074/Psikologji_e_pergjithshme
- Spahiu, S. (1999). Psikologjia-Libri Shkollor,Këshilli Mësimor i SHLP-së në Prishtinë më 19.08.1990.
- Stanley, G. (2019). Approaches to process writing parë më 01.02.2020 në: <https://www.teachingenglish.org.uk/article/approaches-process-writing>
- Woolfok, A. (2011). Educational Psychology, Eleventh edition, PEARSON, 2010 ose shqip: Psikologji edukimi, Universiteti Shtetëror i Ohajës, botuar nga QAD (CDE) ISBN:978-99956-726-7-6, Tiranë, 2011. <https://www.masterclass.com/articles/how-to-write-a-descriptive-essay>
- Edith Cowan University (2018). Centre for Learning and Teaching parë më 01.02.2020 në: https://intranet.ecu.edu.au/_data/assets/pdf_file/0004/772249/creative-thinking.pdf
- How to Teach Creative Writing Activities parë më 01.02.20120 në <http://www.creativewriting-bg.com/assets/HOW-TO-TEACH-CREATIVE-WRITING.pdf>
- Mendimi Kritik dhe Kreativ. (N.d.) (2018) parë më 01.02.2020 në: https://www.australiancurriculum.edu.au/f-10-https://uet.edu.al/images/doktoratura/Nerxhivane_Krasniqi.pdf